



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT**  
**BORDI DREJTUES**

Nr. 61 prot

Tiranë më 17/02 / 2025

3

**PROCESVERBAL**

**MBLEDHJE BORDI**  
**( Datë, 17/02/2025 )**

**Të pranishëm nga Bordi Drejtues:** Të pranishëm nga Bordi Drejtues: Z.Gëzim Peshkëpia, Znj. Enriketa Pandelejmoni, Z.Vasil Tole, Z. Alfred Lako.

**Të pranishëm nga Institut :** Z. Çelo Hoxha

*Hapet mbledhja.*

*Drejtori Ekzekutiv paraqet planin vjetor të punës për vitin 2025.*

**E.Pandelejmoni:** Përshtendetje, unë e pashë planin e punës dhe jam dakort me këtë plan.

**Ç.Hoxha:** Në hartimin e planit jemi kujdesur që punonjësit të jetë të angazhaur në projekte afatgjata, dhe në projekte vjetore. Projektet afatgjata janë kryesisht projekte të natyrës kërkimore, për të cilën punonjësit punojnë në vazhdimësi, dhe mbulojnë pjesën më të madhe të kohës. Projektet vjetore janë projekte që kërkojnë angazhim të përqëndruar brenda një kohe të kufizuar. Projekt vjetor: Përkujtimi i rënies së komunizmit me rastin e 35 vjetorit:

Konferencë shkencore

Tryezë të rrumbullakët me specialistë dhe protagonistë

Konferenca do të jetë ndërkombëtare, me partnerët tanë rumunë dhe në bashkëpunim me institucione të tjera homologe. Tema e konferencës do të përcaktohet nga gjithë faktorët, por do të ketë një sesion vetëm për rënien e komunizmit në Shqipëri. Rënien e komunizmit në gjithë Evropën Lindore e trajtuam në konferencën e vitit të kaluar në Rumani.

Projekt vjetor: Përkujtimi i 35 vjetorit të 2 korrikut 1990, futja e qytetarëve në ambasadat:

Tryezë e rrumbullakët dy seanca: 1) me protagonistë, 2) rreth botimeve të ISKK "Vrasjet në kufi në vitin 1990" dhe "Ngjarje të viteve 1990 - 1991".

Ekspozitë me dokumente.

Përveç çfarë ne kemi në plan, mendojmë të bëjmë një organizim për 15 vjetorin e ISKK si është propozuar nga z.Gëzim.

**E.Pandelejmoni:** Përshëndetje, unë e pashë planin e punës dhe jam dakort me këtë plan Mendoj që për 15-vjetorin e ISKK të bëhet me një kokteil dhe me një përmblëdhjë të punës së Institutit. Mendoj të organizohet nga vjeshta si aktivitet.

**G.Peshkëpia:** Edhe une jam dakort me planin e punës së vitit 2025. Edhe këtë që kam propozuar për 15-vjetorin e ISKK mendoj ta realizoni sa me shpejt brenda vitit.

**A.Lako:** Përshëndetje, unë e lexova relacionin dhe planin dhe jam dakort për miratimin e këtij plani. Gjithashtu jam dakort edhe me organizimin e 15-vjetorit të ISKK.

**V.Tole:** Përshëndetje, e kam parë planin e punës dhe jam dakort. Edhe me pjesën e organizimit të 15-vjetorit të krijimit te iskk jam dakort të bëhet një organizim nga shtatori, nga vjeshta.

**Ç.Hoxha:** Meqë u shprehët që aktivitetin për 15-vjetorin e ISKK ta zhvillojmë nga vjeshta po e lëmë për atë periudhe që të kemi dhe kohë të mjaftueshme për ta organizuar.

*Mbledhja mylllet.*

**Vasil Tole Anëtar .....**

**Enriketa Pandelejmoni Anëtar.....**

**Gëzim Peshkëpia Anëtar.....**

**Alfred Lako Anëtar.....**

**Përpiloj: Liljana Aliko**

